



Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
Regulatorna Komisija Javne Nabavke
Public Procurement Regulatory Commission



Në pajtim me nenin 87, paragrafi 2, nën paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, KRPP nxjerrë këtë:

NJOFTIM

Bazuar në këtë, KRPP kërkon nga të gjithë **Zyrtarët përgjegjës të prokurimit të** Autoriteteve Kontraktuese të Kosovës që të dërgojnë **raportet vjetore për kontratat e nënshkruara publike** për vlera të mëdha, të mesme, të vogla dhe minimale për vitin fiskal 2019, më së largu deri me **10.02.2020** në KRPP.

Meqenëse sistemi gjeneron raportin vjetor të kontratave të nënshkruara publike, të cilat janë zhvilluar përmes platformës së e-prokurimit, nga AK-se kërkohet që raporti i gjeneruar nga sistemi të plotësohet **me aktivitetet e prokurimit me vlerë minimale dhe procedurat tjera të prokurimit të cilat nuk janë zhvilluar përmes platformes së e-prokurimit.**

Formulari B53 - Raporti vjetor mbi kontratat e nënshkruara publike, nxjerret nga platforma elektrtonike, i cili do të plotësohet (kompletohet) me procedurat të cilat nuk janë të përfshira në raportin e sistemit të E- prokurimit dhe duhet të përgaditet dhe dorëzohen në **formën excel në KRPP**. Gjithashtu, në raport të përfshihen edhe numri i aktiviteteve të anuluar dhe/ose të ndara sipas vlerës së kontratës, derisa per procedura te negociuara te specifikohet nese procedura eshte zhvilluar si aneks kontrate.

Adresa elektronike për dërgimin e raporteve është: shpalljekrpp@rks-gov.net
tel: 038-213-710 Formulari B53 Raporti vjetor mbi kontratat e nënshkruara publike ([Shkarko te Legjislacioni Sekondar](#))

16.01.2020
Prishtinë



Kryetari i KRPP-së
Osman Vishaj